

Emri i Lëndës : Planifikimi dhe Vlerësimi I (Arsim Parashkollor)

Kodi	Tipi i lëndës	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
PRD 223	B	3	3	0	0	3.00	5
Lektori dhe orari i konsultimeve			Tidita Abdurrahmani, Prof. Asoc. Dr.				
Asistenti dhe orari i konsultimeve							
Gjuha e kursit			English, Turkish				
Niveli i lëndës			Bachelor				
Përshkrimi			<p>Ky kurs ka për qëllim të: □ krahasojë në mënyrë kritike vlerën, qëllimin dhe përdorimin e vëzhgimeve formale dhe joformale dhe strategjive të vlerësimit dhe implikimet etike , kulturore dhe sociale të tyre në fëmijërinë e hershme . □ aftësojë studentët të përshkruajnë dhe vlerësojnë karakteristikat , anët e forta dhe kufizimet e mjeteve vlerësuese të përbashkëta dhe karakteristikat e aspekteve zhvillimore kulturore dhe gjuhësore të fëmijërisë së hershme. □ demonstrojë metodat sistematike të vëzhgimit, të ofrojë të dhëna për të analizuar ndikimin e mjedisit në vlerësim, dhe ndikimin e bashkëveprimit prind- shkollë- nxënës dhe të kurrikulës në të gjitha fushat e mësimdhënies në fëmijërinë e hershme. □ Të vëre theksin mbi vlerën e partneritetit me familjet dhe profesionistët e tjerë në shfrytëzimin dhe interpretimin e të dhënave vëzhgimore. □ Të paraqesë integrimin e veprimtarive që lidhen me vlerësimin me bazë lojën me mjedisin, kurrikulën dhe përkujdesjen për fëmijët me zhvillim normal dhe ato me aftësi të kufizuara.</p>				
Objektivat			<p>Përmbajtja akademike e këtij kursi përqendrohet mbi përdorimin e duhur të vlerësimit dhe strategjive të vëzhgimit për të dokumentuar rritjen, zhvillimin, lojën dhe të mësuarit e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe për të harmonizuar punën me familjet dhe profesionistët në promovimin e suksesit të fëmijëve. Në kurs shqyrtohen strategji si regjistrimi i të dhënave, sistemet e vlerësimit, portofoli, dhe mjetet e vlerësimit. Ky kurs trajton teorinë e vlerësimit dhe planifikimit për arsimin parashkollor në klasë, jep ilustrime të praktikave të përshtatshme për mësuesit e ardhshëm dhe diskuton tendencat aktuale dhe metodologjitë aktuale të mësimdhënies në arsimin parashkollor. Vlerësimi konsiderohet si një pjesë integrale e procesit të mësimdhënies dhe të të mësuarit, por vëmendje e vecantë i kushtohet edhe vlerësimit gjithëpërfshirës duke adresuar çështje të tilla si ndjeshmëria kulturore, bashkëpunimi prind- mësues-nxënës, përshtatja e praktikave gjithëpërfshirëse të vlerësimit me mjediset ku ky proces zhvillohet. Tematika të trajtuara në këtë kurs përfshijnë testimet me bazë standardet dhe testimet me bazë rezultatet e të nxënësve, testimet e niveleve të larta, rregullimet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me vlerësimin si dhe përfshirja e teknologjisë përkatëse në procesin e vlerësimit.</p>				

Programi i Lëndës

Java	Tema
1	Hyrje në teoritë dhe teknikat e vlerësimit: • Njohja e studentëve me kursin • Prezantimi i silabusit të lëndës • Konsultime me studentët
2	Ngritja e një sistemi gjithëpërfshirës vlerësimi nga lindja përgjatë të gjithë arsimit parashkollor
3	Zhvillimi i partneritetit familje, shkollë, profesionistë në vlerësim
4	Vëzhgimi si metodë bazë për sistemin e vlerësimit
5	Të përdorësh sistemet themelore të matjes
6	Testimi. •të përdorësh masën e duhur për vlerësimin e njohurive
7	Përdorimi i strategjive alternative të vlerësimit. • Mbajtja e shënimeve, raportimi dhe bashkëpunimi me familjen dhe të tjerët për vlerësimin në arsimin parashkollor
8	Provimi i Gjysmefinal

9	Vlerësimi, dhe studimi i etapave të zhvillimit të fëmijëve
10	Çështje të veçanta për vlerësimin në fëmijërinë e hershme
11	Çështje dhe tematika të vlerësimit në arsimin parashkollor
12	Vlerësimi sipas niveleve të mësimdhënies • vlerësimi zyrtar dhe jo-zyrtar • vlerësimi bazuar në rezultatet e të nxënit • vlerësimi bazuar në standarde • hartimi i listave të kontrollit bazuar në standardet kombëtare • përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara
13	Përfshirja e fëmijëve në mbledhjen e të dhënave të portofolit
14	Vlerësimi dhe mësimdhënia e bazuar në standarde
15	Vlerësimi i arritjeve
16	Provimi Final.

Parakushtet	
Literatura	• Wortham, Sue C. Assessment in Early Childhood Education (4th Edition) Prentice Hall 2004 Richmond TX USA
Referenca të tjera	• Mindes, Gayle.(2007)ASSESSING YOUNG CHILDREN , 3rd edition, Pearson Merrill Prentice Hall • Atılgan, H., Kan, A ve Doğan, N. (2007), Measurement and Assessment in Education, Second Edt.. Ankara: Anı Kutlu, Ö., D. Doğan ve İ. Karakaya. (2008), Assessing Student Success. Ankara, Pegem Akademi
Punë laborator	
Përdorimi i komp.	
Të tjera	

Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat

1	krahasojnë në mënyrë kritike vlerën, qëllimin dhe përdorimin e vëzhgimit formal dhe joformal , të njohin strategjitë e vlerësimit dhe implikimet etike kulturore dhe sociale të këtyre strategjive në mjedisin e fëmijërisë së hershme,
2	përshkruajnë dhe vlerësojnë karakteristikat, anët e forta dhe kufizimet e instrumenteve të vlerësimit në përputhje me karakteristikat zhvillimore, kulturore dhe gjuhësore të fëmijëve në fëmijërinë e hershme
3	të njohin më nga afër dhe të kontribuojnë në fuqizimin e partneritetit me familjet dhe profesionistët e tjerë në shfrytëzimin dhe interpretimin e të dhënave vëzhgimore si orientim strategjitë e mësimdhënies
4	të integrojnë aktivitetet që lidhen me vlerësimin brenda mjediseve të lojës, kurrikulave dhe rutinave të kujdesit për fëmijët me zhvillim normal dhe ato me aftësi të kufizuara

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës

Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja
Gjysmë finale	1	25
Kuize	0	0
Projekte	2	20
Projekte semestrare	0	0
Punë laborator	0	0
Pjesëmarrja në mësim	1	10
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final		55
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final		45
Total		100

Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)

Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	2	7	14
Gjysmë finale	1	6	6
Provimi final	1	8	8
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			118
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			4,72
ECTS			5